

# Të **jetosh** me **kujtimet** e të **pagjeturve**

# **Living** with **memories** of the **missing**

# **Živeti** uz **sećanje** na **nestale**

# Të **jetosh** me **kujtimet** e të **pagjeturve**

# **Living** with **memories** of the **missing**

# **Živeti** uz **sećanje** na **nestale**

Integra
Prishtinë | Prishtina | Pristina, 2019

Autori | Author | Autor – **Kushtrim Koliqi**
Fotografia | Photography | Fotografija – **Atdhe Mulla**
Kurator | Curator | Kustos – **Eliza Hoxha**
Intervistues | Interviewer | Ispitivač – **Korab Krasniqi**
Teksti | Text | Teskt – **Dafina Halili**
Transkriptimi | Transcripts | Transkripcija – **Emel Ajdini** | **Djellza Spahiu**
Përkthimi | Translation | Prevod – **Gazmend Bërlajolli** | **Bruno Neziraj**
Dizajni | Design | Dizajn – **Milky Way Creative**
Menaxherë të projektit | Project Managers | Projekt Menadžeri – **Korab Krasniqi | Kushtrim Koliqi**
Bashkëpunëtore | Associate | Stručni saradnik – **Valdete Idrizi**
Dizajni i materialeve për ekspozitë | Design of exhibition materials | Dizajn izložbenih materijala – **Ylber Cërvadiku**
Përgaditja teknike e ekspozitës | Technical preparation of the exhibition | Tehnička priprema izložbe – **Skender Xhikolli**
Shtypi i materialeve te ekspozitës | Print of exhibition materials | Štampa izložbenog materijala – **2B Studio**

Integra | forumZFD Kosovo
Missing Persons Resource Center | Assembly of the Republic of Kosovo
Swiss Cooperation Office Kosovo | Rockefeller Brothers Fund | Federal Ministry for Economic Cooperation and Development
2019, Kosovo



# Të **jetosh** me **kujtimet** e të **pagjeturve**

# **Living** with **memories** of the **missing**

# **Živeti** uz **sećanje** na **nestale**

## HYRJE

Lufta e fundit të viteve të 1990 në Kosovë ka lënë pasoja afatgjata humanitare, socio-ekonomike e politike. Përpos humbjeve njerëzore dhe materiale, dëbimit dhe shpërnguljes të më shumë se 1 milion banorëve, zhvatjes, dhunimit dhe torturimit, lufta e fundit regjistroi numër të lartë të personave të zhdukur. Sipas 'Libër Kujtimi i Kosovës' të Fondit për të Drejtën Humanitare, të vrarë dhe të pagjetur nga data 1 janar 1998 deri më 31 dhjetor 2000 janë 13.535 persona. Të dhënat e siguruara nga Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq tregojnë se me përfundimin e luftës së armatosur në Kosovë, 6.063 persona janë raportuar të zhdukur. Nga ky numër, të vdekur dhe të (ri)varrosur nga familjarët janë raportuar 2.820 persona, të gjallë (të liruar nga burgjet apo të arratisur) raportohen 426 persona, të burgosur mbeten 948 persona dhe raste të mbyllura për shkaqe administrative janë 216 sosh. Numri aktual i personave të pagjetur, fati i të cilëve akoma mbetet i mjegulluar është 1.653.

Siç ilustrojnë figurat e mësipërme, vitet e fundit shënojnë përpjekje të zvogëluara për zbardhjen e fatit të të pagjeturve. Ndarjet e thella dhe antagonizmat politike, lufta për pushtet e legjitimitet politik, paqartësitë rreth kompetencave, bashkëpunimi i vështirësuar me familjarë, mungesa e vullnetit institucional dhe dialogu i cunguar ndërmjet zyrtarëve të Kosovës dhe Serbisë, bëjnë që fati i personave të pagjetur të ketë ngecur në harresë dhe shpresat e familjarëve në mëshirën dhe teket e pushtetarëve.

Ndonëse nga përfundimi i luftës së armatosur, më shumë se 70% e rasteve të raportuara për të pagjetur janë evidentuar, identifikuar dhe mbetjet trupore u janë dorëzuar familjarëve për (ri)varrim, kryerësit e veprave kriminale mbeten akoma të lirë, gjersa një proces i cili garanton drejtësi dhe llogaridhënie mbetet për tu dëshiruar. Në kontekstin e drejtësisë tranzicionale, ligji humanitar ndërkombëtar dhe ligji ndërkombëtar për të drejtat e njeriut, u garanton familjarëve të drejtën për të ditur (të vërtetën) për fatin e më të dashurve të tyre. Në anën tjetër, familjarëve të cilëve mbetjet trupore të më të dashurve të tyre u janë kthyer, u duhet qasje më e theksuar në drejtësi ligjore dhe sociale dhe kujtesë kolektive.

Adresimi i çështjes së të pagjeturve në opinionin publik mbetet proces kompleks diskursiv dhe politik i cili i redukton të pagjeturit në numra dhe i tjetërson ata dhe familjarët e tyre në objekte. Debatet e ngritura rreth kësaj çështjeje shtrihen kryesisht në rrafshin dhe nomenklaturën e mjekësisë ligjore, drejtësisë, të drejtave njerëzore, marrëdhënieve ndërkombëtare, dhe aspekteve që lidhen me kompetencat, gjersa në anën tjetër dhe njëherazi kemi të bëjmë me një proces dehumanizimi të tërësishëm, ku subjektiviteti, përjetimi dhe narrativi personal zhvishet dhe reduktohet në njësi apo vlerë numerike.

Në fillim të vitit 2018, Integra dhe forumZFD programi në Kosovë kanë nisur grumbullimin e

rrëfimeve dhe kujtimeve personale të familjarëve të të pagjeturve, me qëllim parësor që t'u jepet zë grupeve të nën-dhe-keq-përfaqësuara të luftës. Grumbullimi i kujtimeve është kryer me metodën kërkimore të historisë gojore, teksa në proces janë nxjerrë fotografi profesionale të atmosferës në familje, ambientit në shtëpi dhe lagje, si dhe vende e lokacione tjera të risjella në kujtesën e familjarëve që lidhen drejtpërsëdrejti me përjetimet e të pagjeturve. Nga katër familje sa ishin të intervistuara, 3 ishin shqiptare dhe 1 serbe. Njëra nga familjet shqiptare në proces ka përfshirë dy vëllezër të cilëve së bashku u janë zhdukur 5 djem, derisa familja tjetër, po ashtu shqiptare, veç një djali akoma të pagjetur, ka të gjetur trupin e vdekur të djalit tjetër më të vogël i cili konsiderohej i zhdukur për një kohë. Dy familjet tjera kanë të pagjetur nga një anëtar, me familjen serbe të cilët janë në kërkim të fatit të kryefamiljarit të tyre, dhe familjen shqiptare të cilët kërkojnë djalin e tyre, i cili në kohën kur u zhduk ishte 27 vjeç. Rrëfimet e grumbulluara dhe fotografitë e realizuara u përpunuan në një proces kreativ, dhe nga to u sintetizuan video-ekspozita të shkurtra, nëpërmjet së cilave u bë përpjekje që të tregohet historia tragjike e familjeve të intervistuara. Këto materiale u transmetuan çdo javë në njërën prej televizioneve me mbulesë kombëtare, për pesë javë me radhë. Video ekspozitat kishin për synim riorientimin e diskursit publik mbi të pagjeturit dhe ri-jetësimin e kujtimeve për ta. Ndërsa, nëpërmjet avokimit strategjik, projekti mëtonte krijimin e hapësirave për dialogim kolektiv dhe shkëmbim në funksion të memorializimit.

Faza përcjellëse përfshin realizimin e ekspozitës të titulluar "Të jetosh me kujtimet e të pagjeturve" e cila ndërtohet në baza të një hulumtimi të thukët të deskut, historive gojore dhe fotografive të realizuara me familjarë të personave të pagjetur. Ekspozita vendoset në hapësirat e Parlamentit të Republikës së Kosovës kështu duke rezonua mesazhe të fuqishme simbolike rreth asaj se në cilin drejtim graviton përgjegjësia më e madhe në raport me punën drejt zbardhjes së fatit të të pagjeturve.

Nëpërmjet gërshetimit të punës hulumtuese, fotografisë dhe një koncepti kuratorial kreativ, ekspozita synon që të cyt punën e institucioneve publike, politik-bërësve dhe akterëve tjerë në fushën Drejtësisë Tranzicionale drejt zbardhjes së fatit të personave të pagjetur nga lufta e fundit në Kosovë. Projekti dhe ekspozita gjithashtu ka për qëllim që t'i mbështesë familjarët e personave të pagjetur në një proces që iu garanton të drejtën për të ditur dhe statusin e dëshmitarëve historik, si dhe pjesëmarrjen në formësimin e kujtesës kolektive.

**Korab Krasniqi**
Intervistues dhe menaxher në projekt

## INTRODUCTION

The war of late 1990 in Kosovo left long-term humanitarian, socio-economic and political consequences. Apart from human and material losses, deportations and displacements of more than 1 million people, extortion, rape and torture, the war registered a high number of missing persons. According to the "Kosovo Memory Book" of the Humanitarian Law Center, from 1 January 1998 to 31 December 2000, 13,535 persons were killed and went missing. The data provided by the International Committee of the Red Cross show that at the end of the armed conflict in Kosovo, 6,063 persons were reported missing. Of those, 2.820 are reported dead and (re)buried by family members, 426 reported as alive (released from prisons or fugitives), 948 persons remain imprisoned and 216 are closed cases for administrative reasons. The number of missing persons, whose fate still remains unclear, is 1.653.

As the above figures illustrate, efforts to uncover the fate of the missing have diminished in recent years. Deep political divisions and antagonisms, the struggle for power and political legitimacy, ambiguity over competencies, complicated co-operation with family members, lack of institutional will and curtailed dialogue between Kosovo and Serbia officials have made the fate of missing slide into oblivion and hopes of family members remain in the mercy and caprice of politicians.

Although over 70% of cases of missing persons reported since the end of the armed conflict are identified and bodily remains were handed over to families for (re)burial, perpetrators of criminal offenses are still at large, while a process guaranteeing justice and accountability remains but a desire. In the context of transitional justice, the international humanitarian law and international human rights law guarantee family members the right to know (the truth) about the fate of their loved ones. On the other hand, family members to whom bodily remains of the loved ones have been returned, need a more explicit approach to legal and social justice as well as collective memory.

The issue of public address of the missing persons remains a complex discursive and political process that reduces the missing into numbers, alienating them and their family members. The debates on the issue orbit mainly around the topic and the nomenclature of forensics, justice, human rights, international relations, and aspects related to competencies, while on the other hand and simultaneously we are dealing with an entire process of dehumanization whereby subjectivity, personal experience and narrative are stripped off and reduced to a numeric unit or value.

At the beginning of 2018, Integra and forumZFD program in Kosovo started collecting personal memories and stories from family members of the missing, with the primary aim of giving voice to the under-and-miss-represented groups emerging from the war. The collection of memories was done with the oral history research method, while professional photos of the family atmosphere, home and neighborhood environment, as well as other locations that were brought to the memory of families, related to the experiences of their missing loved ones were taken in the process. Of the four families interviewed, three were Albanian and one Serb. One of the Albanian families involved two brothers who jointly lost five sons, while the other family, also Albanian, apart from a still missing son, has found the body of the other younger son, considered missing for a while. The other two families have each one member unaccounted for, with the Serbian family seeking the whereabouts of their family head and the Albanian family looking for their son, who went missing at 27.

The collected narratives and photographs were processed through a creative process and short video exhibitions were then produced aiming to narrate the tragic stories of the interviewed families. The material was aired on weekly basis in one of the tv outlets with national coverage for five weeks in a row. The video exhibitions were aimed at channeling the public discourse towards the missing and reviving the memory of them. On the other hand, through its strategic advocacy, the project sought to stir a collective dialogue and exchange with the aim of memorialization.

The accompanying phase includes the exhibition titled "Living with Memories of the Missing", built on the basis of a thorough desk research, oral histories and photos taken with family members of the missing. The exhibition is placed in the premises of the Parliament of the Republic of Kosovo thus sending powerful symbolic messages about where the greatest responsibility lies with regards to uncovering the fate of the missing.

By combining the research work, photography and a creative curatorial concept, the exhibition aims to incite  the work of public institutions, policy-makers and other stakeholders of Transitional Justice to uncover the fate of missing persons from the recent war in Kosovo. The project and exhibition also aim to support family members of the missing in a process that guarantees them the right to know and the status of historical witnesses, as well as their participation in shaping collective memory.

**Korab Krasniqi**
Interviewer and project manager

## UVOD

Poslednji rat devedesetih na Kosovu ostavio je dugoročne humanitarne, društveno-ekonomske i političke posledice. Pored ljudskih i materijalnih gubitaka, izgona i raseljavanja više od 1 miliona stanovnika, iznuda, silovanja i mučenja, poslednji rat je zabeležen velikim brojem nestalih osoba. Prema podacima Kosovske knjige pamćenja Fonda za humanitarno pravo, od 1. januara 1998. do 31. decembra 2000. je ubijeno ili nestalo 13.535 osoba. Podaci koje je obezbedio Međunarodni komitet Crvenog krsta pokazuju da se je završetkom oružanih sukoba na Kosovu nestalima i dalje vodilo 6.063 osoba. Od tog broja, mrtvih i (ponovo) sahranjenih od strane članova porodica je bilo prijavljeno 2.820 osoba, živih (oslobođeni iz zatvora ili pobegli) 426 osoba, u zatvoru je bilo ostalo 948 osoba, a prijavljeni broj predmeta zatvorenih zbog upravnih razloga je bio 216. Trenutni broj nestalih osoba, čija je sudbina još uvek nepoznata, je 1.653.

Kao što ilustruju gore prikazane brojke, poslednjih godina se uočavaju smanjeni napori da se rasvetli sudbina nestalih. Duboke podele i politički antagonizmi, borba za moć i politički legitimitet, nejasnoće u ovlašćenjima, otežana saradnja sa članovima porodica, nedostatak institucionalne volje i zabarikadirani dijalog između zvaničnika Kosova i Srbije čine da sudbina nestalih osoba ostane u zaboravu i nadanjima članova porodica u milost i hirove vlastodržaca.

Iako je od završetka oružanih sukoba registrovano više od 70% slučajeva prijavljenih nestalih osoba, identifikovani su i posmrtni ostaci i predati članovima porodica za (ponovnu) sahranu, počinioci krivičnih dela su i dalje na slobodi, dok postupak koji garantuje pravdu i odgovornost ostaje samo želja. U kontekstu tranzicione pravde, međunarodno humanitarno pravo i međunarodno pravo o ljudskim pravima garantuju članovima porodica pravo da znaju (istinu) o sudbini njihovih najmilijih. S druge strane, članovima porodica kojima su vraćeni posmrtni ostaci njihovih najmilijih je potreban izraženiji pristup pravnoj i socijalnoj pravdi i kolektivnom pamćenju.

Adresiranje pitanja nestalih osoba u javnom mnjenju ostaje složen diskurzivni i politički proces koji smanjuje nestale osobe na brojke i menja njih i članove njihovih porodica u objekte. Pokrenute diskusije o ovom pitanju uglavnom se odnose na domen i nomenklaturu sudske medicine, pravde, ljudskih prava, međunarodnih odnosa i aspekata vezanih za nadležnost, dok se s druge strane istovremeno suočavamo sa procesom potpune dehumanizacije gde su lična subjektivnost, iskustvo i naracija poništeni i svedeni na jediničnu ili numeričku vrednost.

Početkom 2018. program Integra i forumZFD na Kosovu su počeli da prikupljaju priče i lična

sećanja članova porodica nestalih osoba, sa primarnim ciljem da daju glas grupama iz rata koje su bile nedovoljno ili pogrešno zastupljene. Zbirka sećanja sprovedena je istražnom metodom usmenih doživljaja, dok su tokom procesa izvedene profesionalne fotografije atmosfere u porodici, ambijenta u domu i naselju, kao i na drugim lokacijama koje su obnovljene u sećanjima članova porodica i koje su direktno povezane sa iskustvima nestalih. Od četiri intervjuisane porodice, 3 su albanske i 1 srpska. Jedna od albanskih porodica u procesu uključuje dva brata kojima je nestalo ukupno 5 sinova, dok je druga porodica, takođe albanska, pored jednog sina koji se još uvek vodi kao nestao, pronašla besmrtno telo drugog, mlađeg sina, koji se je vodio nestalim dugo vremena. Ostale dve porodice imaju po jednog nestalog člana, srpska porodica koja ne zna sudbinu glave porodice i albanska porodica koja traži svog sina, koji je u vreme nestanka imao 27 godina.

Prikupljene priče i realizovane fotografije su razrađene u kreativnom procesu, a iz istih su sintetizovane kratke video izložbe, preko kojih je uložen napor da se podeli tragični istorijat intervjuisanih porodica. Ovi materijali su emitovani svake nedelje na jednoj od televizijskih stanica sa nacionalnom frekvencijom, pet nedelja zaredom. Video izložbe su imale za cilj preorijentaciju javnog diskursa o nestalim i zaživljavanje sećanja na njih. Dok je kroz strateško zagovaranje projekat nastojao da stvori prostor za kolektivni dijalog i razmenu u funkciji memorijalizacije.

Sledeća faza uključuje realizaciju izložbe pod naslovom "Živeti uz sećanje na nestale", koja je izgrađena na osnovu detaljnog desk istraživanja, usmenih priča i fotografija snimljenih sa članovima porodica nestalih osoba. Izložba je postavljena u prostorijama Skupštine Republike Kosovo, na taj način rezonujući snažne simboličke poruke o smeru u kojem leži najveća odgovornost u radu na rasvetljavanju sudbine nestalih.

Kroz preplitanje istraživačkog rada, fotografije i kuratorno-kreativnog koncepta, izložba ima za cilj da podstakne rad javnih institucija, izradilaca politika i drugih aktera u oblasti tranzicione pravde na rasvetljavanju sudbine nestalih osoba iz poslednjeg rata na Kosovu. Projekat i izložba takođe imaju za cilj da podrže članove porodica nestalih u procesu koji garantuje pravo da znaju i status istorijskih svedoka, kao i učešće u oblikovanju kolektivnog pamćenja.

**Korab Krasniqi**
Anketar i menadžer projekta

Të jetosh me kujtimet e të pagjeturve...

Fytyra të zbehta, dashuri peng, dhimbje e kujtime që nuk shuhen.

## PRITJE.

Pritje pafund që dhimbja të marri emrin e shpirti të gjejë vendin. E zemra ka mall për një trokitje në derë, një shpresë që vazhdon t'i mbajë në jetë familjarët e të pagjeturve në Kosovë. Çështja e **1653**[1] të pagjeturve nga lufta në Kosovë ende nuk ka marr përgjigje. Rrëfime të shumta brenda dhomave të familjarëve zor se na bijnë në veshin tonë. Ato mbeten të mbyllura brenda familjeve përderisa ne flasim për numrin – emrat janë mister për ne e për familjarët një prezencë në mungesë. Është shumë e vështirë të ilustrosh diçka në mungesë. Si mund të flasim vizuelisht dhe artistikisht për të pagjeturit?!

Integra dhe forumZFD programi në Kosovë kanë intervistuar familjarë të të pagjeturve dhe kanë sjellë për të parën herë kujtimet e tyre të cilat marrin formën vizuale dhe vijnë para nesh nga afër në një hapësirë institucionale ku dialogu për ta është domosdoshmëri dhe obligim për ti dhënë fund pritjes së tyre të përhershme. Nga një derë për çdo familje, nga një copëz rrëfimi të familjarëve thuajse po dalin nga muret dhe po na flasin neve që nuk e njohim dhimbjen e tyre, nuk e njohim pritjen e tyre dhe lirinë e cunguar. Nga një çelës për çdo emër të munguar por edhe për çdo zemër peng që të çlirohet nga ankthi dhe lodhja për një përgjigje dhe për një vend për tu shënjuar. Kjo gjendje e familjarëve të të pagjeturve në pritje tash 20 vite vjen si në një tunel i pafund i formësuar në hapësirat e Kuvendit të Kosovës.

E nesërmja duket e largët për secilin familjarë, ndërsa ne si institucione dhe si shoqëri duhet të bëjmë më shumë për një të nesërme më të mirë për ta.

**Eliza Hoxha**
Kuratore e ekspozitës

[1] ICRC

Pale faces, pendent love, pains and memories that do not vanish.

## WAITING

Endless waiting for the pain to get a name and the soul to find its place. The heart craves for a knock on the door, a hope that family members of the missing in Kosovo still nourish. The issue of 1653 missing[1] from the war in Kosovo has yet to be resolved. Numerous stories told within the households of family members hardly reach our ears. They remain enclosed within their houses while we discuss the numbers – the names are a mystery to us and to the family members a presence in absence. It is very difficult to illustrate something absent. How can we visually and figuratively talk about the missing? Integra and the forumZFD program in Kosovo have interviewed family members of the missing and for the first time brought their memories that take a visual form, coming before us in an institutional space where discussing them is a necessity and an obligation to put an end to their perpetual waiting. A door from each family, a piece of story from family members are as if coming out of the walls to talk to us who do know of their pain, their waiting and their curtailed freedom. A key for each missing name and also every pendant heart to be relieved of its anxiety and fatigue over an answer and a place to be marked. The situation of the family members of missing who have been waiting for 20 years comes as an infinite tunnel created in the premises of the Kosovo Assembly.

Tomorrow seems distant to each family member, while we as institutions and a society must do more for a better tomorrow for them.

**Eliza Hoxha**
Exhibition curator

[1] ICRC

Živeti uz sećanje na nestale ...

Izbledela lica, zatočena ljubav, bol i uspomene koje se ne gase.

## ČEKANJE.

Beskrajno čekanje da bol bude imenovana i duša nađe mesto. A srce žudi za kucajem na vratima, nada koja nastavlja da održava u životu porodice nestalih na Kosovu. Pitanje 1653 nestalih tokom poslednjeg rata na Kosovu još nije dobilo odgovor. Brojne priče u sobama članova porodica teško dopiru do našeg uha. Ostaju zatvorene u porodicama dok mi govorimo o brojkama – imena su zagonetka za nas, a za članove porodica prisustvo u odsustvu. Veoma je teško ilustrovati nešto u odsustvu. Kako možemo vizualno i figurativno govoriti o nestalima?!

Integra i forumZFD program na Kosovu su intervjuisali članove porodica nestalih i po prvi put su predstavili njihova sećanja koja dobijaju vizuelni oblik i izlaze pred nas u institucionalnom prostoru gde je dijalog za njih neophodnost i obaveza kako bi se okončalo njihovo beskonačno čekanje. Po jedna vrata za svaku porodicu, po jedan delić porodičnih priča skoro da izlazi iz zidova i obraća nam se, nama koji ne znamo njihovu bol, ne znamo njihova očekivanja i uskraćenu slobodu. Po jedan ključ za svako ime koje nedostaje, ali i svako zatočeno srce kako bi se oslobodilo anksioznosti i umora u čekanju odgovora i za jedno mesto koje treba obeležiti. Ova situacija članova porodica nestalih, koji već 20 godina čekaju, nam dolazi kao beskonačni tunel koji je formiran u prostorijama Skupštine Kosova.

Sutrašnjica izgleda daleko svakoj porodici, a mi, kao institucije i društva, moramo učiniti više za njihovu bolju sutrašnjicu.

**Eliza Hoxha**
Kustos izložbe

[1] MKCK

TË JETOSH ME KUJTIMET E TË PAGJETURVE

TË JETOSH ME KU
NJE NA NESTALE
WITH MEMORIES OF THE MISSING
ŽIVETI UZ S
JE NA NESTALE
TË JETOSH
OSH ME KUJTIMET E TË PAGJETURVE

LIVING WITH MEMORIES OF THE MISSING

THE MISSING
ŽIVETI UZ S
ETURVE
TË JETOSH
OSH ME KUJTIMET E TË PAGJETURVE
TH MEMORIES OF THE MISSING

ŽIVETI UZ SEĆANJE NA NESTALE



NJË DJALË I VRARË,
NJË DJALË I ZHDUKUR,
DY PRINDËR TË DËSHPËRUAR

A DEAD SON,
A MISSING SON,
TWO DESPERATE PARENTS!

JEDAN SIN UBIJEN,
JEDAN NESTAO,
DVA OČAJNA RODITELJA!

Nezir Avdyli,
Hamide Avdyli



## NJË DJALË I VRARË,
## NJË DJALË I ZHDUKUR,
## DY PRINDËR TË DËSHPËRUAR

Fadil Avdyli për herë të fundit u pa me 16 prill 1999, i plagosur në krah. Ai kishte arritur të arratisej nga një masakër, ku u vranë dhjetëra shqiptarë të Mitrovicës, në mesin e të cilëve ishte edhe vëllai tij Fatmiri. Fadili ishte vetëm 24 vjeç kur u bë dëshmitar i vrasjes së vëllait të tij 16 vjeçar.

Fatmiri u varros në Vaganicë të Mitrovicës nga pjesëtarët e UÇK-së, të cilët kishin gjetur trupat e vrarë në masakër. Fadili shpëtoi nga masakra por u zhduk menjëherë pas.

Hamides, që kishte rritur me vuajtje e vështirësi tetë fëmijë, jeta i'u bë edhe më e vështirë pa Fadilin dhe Fatmirin. Ata u ndanë nga familja me brengën për fatin e nënës së tyre që po e lenin në shtëpi Gentritin e vogël në duar.

"Çka t'bojna ty nanë? T'kemi nanë t'mirë për veti."

Ajo sot ngushëllohet nga nipërit e vegjël, ku njëri e mban emrin e Fatmirit. Por emrin e Fadilit nuk dëshiron ta ripërtërijë në nipa. Ajo ende pret kthimin e tij.

Neziri, babai i Fadilit dhe Fatmirit, kujton se si djemtë ishin të urtë, të mirë e të shoqërueshëm. Fatmiri ishte futbollist shumë i mirë dhe ëndërronte që të bëhej futbollist profesional.

"... po boni vaki diçka mos më vajto... se unë po shkoj e po luaj me top"

Por Neziri, përveç dhimbjes së rëndë për humbjen e djemve, vuan ende dhimbjet fizike të torturave që i kishin bërë policët dhe paramilitarët serbë gjatë ditëve që kishte kaluar në burgun e Mitrovicës.

I zhgënjyer me mungesën e interesimit të qeverisë mbi fatin e personave të pagjetur, Neziri bën thirrje që institucionet të angazhohen më shumë për drejtësi dhe për gjetjen e këtyre personave.

Hamidja dhe Neziri nuk dinë asnjë gjë se çka ka ndodhur me Fadilin, e nga Fatmiri iu kanë mbetur rrobat që i kishte veshur kur u vra. Hamidja deri vonë kishte ruajtur rrobat e dy djemve, të cilët shpesh i paraqiten në ëndrra për të biseduar me të.

'I shihsha në ëndërr që po vijnë të dytë. Folsha me ta'

# A DEAD SON, A MISSING SON, TWO DESPERATE PARENTS!

Fadil Avdyli was last seen on April 16, 1999, injured in his arm. He had managed to escape a massacre where dozens of Albanians from Mitrovica were killed, including his brother Fatmir. Fadil was only 24 when he became a witness to the murder of his 16-year-old brother.

Fatmir was buried in Vaganica, Mitrovica, by members of the KLA, who had found the bodies killed in the massacre. Fadil escaped the massacre but disappeared shortly after.

The life of Hamide, who had raised eight children with suffering and difficulty, became even more difficult without Fadil and Fatmir. They separated from the family with the concern for the fate of the mother they were leaving at home with little Gentrit in her arms.

"What shall we do for you mother? You are a good mother to us."

Today she is comforted by little grandchildren, one of whom holds the name of Fatmir. But Fadil's name she does not want to renew with her grandchildren. She still expects him to return.

Nezir, the father of Fadil and Fatmir, recalls how the boys were wise, good and sociable. Fatmir was a very good football player and dreamed of becoming a professional footballer.

'Should anything happen, do not cry for me… I am going to play with my ball'

Nezir, apart from the deep sorrow from having lost two sons, still suffers the physical damage from the tortures he was subjected to by the Serbian policemen and paramilitaries while being kept in the Mitrovica prison.

Disappointed with the government's lack of interest on the fate of the missing persons, Nezir calls on the institutions to engage more for justice and on finding these persons.

Hamide and Nezir have no idea what might have happened to Fadil, while from Fatmir they still have the clothes he was wearing when he was shot. Hamide until very recently had kept the clothes of both sons, who often appear in her dreams.

'I would see them both in a dream coming back home. I would speak to them'

## JEDAN SIN UBIJEN, JEDAN NESTAO, DVA OČAJNA RODITELJA!

Fadil Avdyli je poslednji put viđen 16. aprila 1999. sa ranom na ramenu. On je bio uspeo da pobegne od masakra u kojem je ubijeno na desetine Albanaca u Mitrovici, a među kojima i njegov brat Fatmir. Fadil je imao samo 24 godine kada je postao svedok ubistva njegovog 16-godišnjeg brata.

Fatmira su sahranili u Vaganici u Mitrovici pripadnici OVK-a koji su pronašli tela ubijenih u masakru. Fadil je preživeo masakr ali je odmah posle toga nestao.

Hamidi, koja sa poteškoćama je odgajala osmoro dece, život je postao još teži bez Fadila i Fatmira. Oni su se odvojili od porodice uz zabrinutost o sudbini njihove majke, koju su ostavljali u kući sa malim Gentritom u rukama. "Šta da radimo s tobom majko? Dobra si majka za nas".

Nju danas teše mali unuci, a jedan od njih nosi Fatmirovo ime. Međutim, Fadilovo ime ne želi da obnovi među unucima. Ona još čeka na njegov povratak.

Nezir, Fadilev i Fatmirov otac, se seća da su mu sinovi bili mirni, dobri i druželjubivi. Fatmir je bio veoma dobar fudbaler i sanjao je da postane profesionalan fudbaler.

“... ako se nešto desi nemoj me oplakivati... jer idem da igram lopte”

Međutim Nezir pored teškog bola zbog gubitka dece, pati i od fizičkih bolova zbog mučenja srpske policije i paravojnih formacija tokom dana koje je proveo u zatvoru u Mitrovici.

Razočaran nedostatkom interesovanja vlade za sudbinu nestalih, Nezir poziva da se institucije angažuju više na pravdi i pronalaženju ovih lica.

Hamida i Nezir ne znaju ništa šta se desilo sa Fadilom, dok im je od Fatmira ostala odeća koju je nosio kada je ubijen. Hamide je do nedavno čuvala odeću oba sina, koji joj se često javljaju u snovima kako bi razgovarali sa njom.

"Sanjala sam ih obojicu kako dolaze. Pričala sam sa njima".



TË JETOSH ME KUJTIMET
E TË PAGJETURVE

LIVING WITH THE MEMORIES
OF THE MISSING

ŽIVETI UZ SEĆANJE
NA NESTALE









NJË DJALË I VRARË,
NJË DJALË I ZHDUKUR,
DY PRINDËR TË DËSHPËRUAR

A DEAD SON,
A MISSING SON,
TWO DESPERATE PARENTS!

JEDAN SIN UBIJEN,
JEDAN NESTAO,
DVA OČAJNA RODITELJA!














TË JETOSH ME KUJTIMET E TË PAGJETURVE

LIVING WITH MEMORIES OF THE MISSING

ŽIVETI UZ SEĆANJE NA NESTALE



# NË AGONI TË VAZHDUESHME

# CONTINUOUS AGONY

# U STALNOJ AGONIJI

Halil Ujkani,
Sadri Ujkani




# NË AGONI TË VAZHDUESHME

Për dy vëllezërit, Halil dhe Sadri Ujkani jeta ishte e lumtur kur rreth 35 anëtarë të familjes, të vegjël e të mëdhenj, jetonin bashkërisht. Por në prill të vitit 1999 jeta e tyre u kthye në betejë të vazhdueshme.

Në mes atmosferës së tmerrit, derisa forcat serbe kishin zënë çdo cep të fshatit, pesë djem të familjes Ujkani ikën nga shtëpia për të mos u kthyer më.

Shaipi dhe Mahiti, dy djem të Halilit, Fatoni dhe Shkelzeni, dy djem të Sadriut, dhe Nazimi, djali i Zahitit, vëllait të tretë, nuk kishin arritur ta lëshonin Kosovën siç bënë vëllezërit e tyre dhe një pjesë e madhe e rinisë shqiptare gjatë viteve '90.

Pesë djemtë u larguan nga shtëpia e tyre me 16 prill 1999, një ditë para se forcat serbe të dëbonin gjithë banorët shqiptarë të asaj ane. "Nuk u ndajshin ditë e natë, e zaten shkuan bashkë dhe nuk u ndanë," thotë Sadriu.

Pesë djemtë për herë të fundit u panë në shkollën "Haxhi Sulejmani" (ish "Sveti Sava") ku po mbaheshin nga policia serbe. Një fqinj i familjes, që i kishte parë aty, pohon se policët serbë diskutonin që të arrestuarit shqiptarë do t'i dërgonin në burgun famëkeq me të burgosur politikë në Pozharevac. Por pas kësaj, asnjëherë asgjë nuk u morr vesh për ta.

Të ngërthyer në mes shpresës që djemtë i kanë ende të gjallë, dhe vuajtjes nga mendimi se ata mund të jenë vrarë, familja Ujkani nuk ka lënë derë pa trokitur për t'i gjetur ata. Madje dhanë mijëra euro, për të përfunduar të mashtruar nga persona të ndryshëm, që u premtonin se do t'ua gjenin djemtë.

Ata ndihen të gënjyer edhe nga institucionet shtetërore për atë që nuk arritën të zbardhin asgjë dhe se çështjen e të pagjeturve asnjëherë nuk e përfshinë në negociatat me Serbinë.

Prindërit e Shaipit, Mahitit, Fatonit, Shkelzenit dhe Nazimit përkundër lodhjes nga vuajtja e pritjes, nuk duan të besojnë që djemtë i kanë të vrarë. Tek çdo shoqe a shok i tyre, shohin fëmijët e vet, të cilët kur ikën ishin studentë dhe nxënës ndërsa sot do të ishin rreth të dyzetave.

"Së paku t'u kisha thënë 'udha e mbarë'" – shprehet Sadri Ujkani, babai i Fatonit dhe Shkelzenit, i cili kurrë nuk kishte menduar që djemtë dhe nipat e tij s'do të kthehen më.

## CONTINUOUS AGONY

For the two brothers, Halil and Sadri Ujkani, life was happier when nearly 35 family members, young and old, lived together. But since April 1999, life became a constant battle.

Between the atmosphere of horror, while Serb forces had occupied every corner of the village, five Ujkani family men left the house to not return anymore.

Shaip and Mahit, two of Halil's sons, Faton and Shkelzen, Sadri's sons, and Nazim, the son of the third brother Zahit, could not leave Kosova the way their brothers and a large part of Albanian youth during the '90s did.

The five boys left the house on April 16, 1999, one day before Serbian forces expelled all Albanian residents of that area.

'They would not split day or night, and they went together and did not split,' Sadri says.

The five boys were last seen in the "Haxhi Sulejmani" school where they were being held by Serbian police. A neighbor of the family, who had seen them there, claims that Serbian police were discussing of sending the Albanian arrestees to the notorious prison in Pozharevac with political prisoners. But after that, nothing was ever known about them.

Cluttered between the hope that the sons are still alive and the suffering from the thought that they may have been killed, Ujkani family has knocked on every possible door in order to find them. They even gave thousands of euros to end up deceived by various people promising them to find the boys.

They also feel disappointed by state institutions for failing to reveal anything and for not having the issue of the missing ever included in negotiations with Serbia.

Shaip's, Mahit's, Faton's, Shkelzen's and Nazim's parents, in spite of the fatigue and the suffering from waiting, do not want to believe that the boys are killed. At each of their friends they see their own children, who when they left were students and pupils, and today would be in their forties.

"Had I at least said, 'have a nice trip' to them," says Sadri Ujkani, father of Faton and Shkelzen, who never thought that his sons and nephews would never return again.

## U STALNOJ AGONIJI

Za dva brata, Halila i Sadrija Ujkanija, život je bio srećan dok je otprilike 35 članova porodice, malih i velikih, živelo zajedno. Međutim, u aprilu 1999. njihov život je postao stalna borba.

U sred atmosfere užasa, dok su srpske snage zauzimale svaki ćošak sela, pet sinova porodice Ujkani je pobeglo od kuća kako se nikada više ne bi vratili.

Shaip i Mahit, dva Halitova sina, Faton i Shkelzen, dva Sadrijina sina, i Nazmi, Zahitov sin, trećeg brata, nisu uspeli da napuste Kosovo, kao što su to učinila njihova braća i veliki deo albanske omladine tokom '90-ih.

Petoro momaka je napustilo svoje kuće 16. aprila 1999, jedan dan pre što su srpske snage proterale sve albanske stanovnike sa tog područja.
"Nisu se odvajali dan ni noć, a bogami, otišli su zajedno i nisu se odvojili", kaže Sadri.

Petoro momaka je poslednji put viđeno u školi "Haxhi Sulejmani" (bivša Sveti Sava), gde ih je držala srpska policija. Jedan sused porodice, koji ih je tu video, tvrdi da su srpski policajci diskutovali da albanske zatvorenike odvedu u ozloglašeni zatvor za političke zatvorenike u Požarevcu. Međutim, posle ovog, o njima se više nikada nije ništa čulo.

Uhvaćena između nade, da su im sinovi još živi, i patnje, od mišljenja da su možda ubijeni, porodica Ujkani je kucala na sva vrata kako bi ih pronašla. Čak su i dali na hiljade evra, kako bi na kraju bili izigrani od strane raznih ljudi, koji su im obećavali da će im pronaći sinove. Osećaju da su ih i državne institucije prevarile jer nisu uspele da rasvetle ništa i zato što pitanje nestalih nikada nije uključeno u pregovore sa Srbijom.

Roditelji Shaipa, Mahita, Fatona, Shkelzena i Nazima uprkos umoru od bola čekanja, ne žele da veruju da su im sinovi ubijeni. Kod svake njihove drugarice ili druga vide svoju dete, koje je nestalo dok su bili studenti i učenici, a danas bili u četrdesetima.

"Da sam im najmanje rekao "Srećan put"" – kaže Sadri Ujkani, Fatonov i Shkelzenov otac, koji nikada nije mislio da mu se sinovi i sinovci više nikada neće vratiti.


















TË JETOSH ME KUJTIMET E TË PAGJETURVE

LIVING WITH MEMORIES OF THE MISSING

ŽIVETI UZ SEĆANJE NA NESTALE

TË JETOSH ME KU NJE NA NESTALE
WITH MEMORIES OF THE MISSING
ŽIVETI UZ S JE NA NESTALE
TË JETOSH OSH ME KUJTIMET E TË PAGJETURVE
THE MISSING
ŽIVETI UZ S ETURVE
TË JETOSH OSH ME KUJTIMET E TË PAGJETURVE
TH MEMORIES OF THE MISSING



# PËR OLGEN LUFTA KA FILLUAR MË VONË

# FOR OLGA THE WAR STARTED LATER

# ZA OLGU JE RAT POČEO KASNIJE

Olga Stajnovic



## PËR OLGEN LUFTA KA FILLUAR MË VONË

Olga Stajnovic ishte rritur duke ëndërruar që të bëhej muzikante. Ajo kujton kohët e mira kur me bashkëshortin e saj Markon punonin në arsim, së bashku me shqiptarët, me të cilët ndanin gëzimet e hidhërimet, festat e Pashkëve dhe të Bajramit.

Kurrë nuk do ta kishte menduar që do ta përjetonte humbjen e fëmijës, kur djali 22 vjeçar, Srgjani u vra aksidentalisht duke kaluar shinat e trenit në 1997. Por, edhe me pak e kishte pritur që do ta humbte edhe Markon, që do t'i digjej shtëpia në Ferizaj dhe do të mbetej pothuajse në vetmi në fshatin Zhupë të Shtërpcës.

Për herë të fundit Marko ishte parë në një shkollë në Ferizaj, më 28 shtator të vitit 1999. Nën shoqërimin e KFOR-it polak ai kishte shkuar për të marrë dokumentacionin e punëtorëve serbë të arsimit. Pjesëtarët e KFOR-i e lanë Markon në shkollë dhe shkuan për të shoqëruar dikë në një vizitë afër. Kur e kthyen Markon nuk e gjetën.

E zhgënjyer, Olga përpiqej e vetme për zbardhjen e fatit të Markos. Krejt çka mori ajo nga autoritet e KFOR-it ishte një "vërtetim" në të cilin thuhej se Marko është vrarë brutalisht. Por trupi i tij nuk u gjet asnjëherë. Ai u zhduk në përvjetorin e dytë të vdekjes tragjike të djalit, Srgjanit.

Olga kujton fjalët e fundit të tij para se të nisej në Ferizaj. "Nëse më nodh diçka, të lutem ma ruaj familjen". Ishte i veshur në të zeza, ngase ende mbante zi për nënën që i kishte vdekur 5 muaj më herët.

Olga kujton bashkëshortin e saj, që ishte njeri i ndershëm, modest, solidar dhe shumë punëtor. Ai ndihmonte njerëzit pavarësisht nacionalitetit dhe gjendjes ekonomike. Ajo gjenë forcë për të vazhduar jetën, duke kujtuar kurajon e Markos për të ecur përpara. Po ashtu, Olga shpreson që një ditë shqiptarët dhe serbët do të tejkalojnë pengesat që u vendosen nga qeveritë e tyre. Por ajo e di që do të gjejë paqe, vetëm atëherë kur Marko do të ketë një varr pranë djalit të tyre.

## FOR OLGA THE WAR STARTED LATER

Olga Stajnovic had grown up dreaming of being a musician. She remembers the good times when with husband Marko they worked in education, alongside with Albanians, with whom they shared the joys and sorrows, Easter and Eid holidays.

Never would she have thought that she would experience the loss of her child, when the 22-year-old son, Srdjan, was accidentally killed crossing the train track in 1997. But even less did she expect that she would lose Marko too, and that her house in Ferizaj would burn and she would remain almost alone in the village of Zhupa in Shtërpce.

For the last time, Marko was seen at a school in Ferizaj on September 28, 1999. Accompanied by Polish KFOR he had gone to get the documentation of the Serbian education workers. KFOR members had left Marko in school and gone to accompany someone in a nearby visit. They had returned but had not found Marko.

Disappointed, Olga was struggling to unfold Marko's fate on her own. All that she received from the KFOR authorities was a "confirmation" stating that Marko was brutally murdered. But his body was never found. He disappeared on the second anniversary of the tragic death of his son, Srdjan.

Olga remembers his last words before he headed to Ferizaj. "If something should happen to me, please keep my family safe." She was dressed in black because he was still mourning her mother who had died five months earlier.

Olga remembers her husband as an honest, modest, solidary, and hardworking man. He helped people regardless of nationality and financial status. She finds strength to continue her life, remembering Marko's courage to move forward. Also, Olga hopes that one day Albanians and Serbs will overcome the obstacles imposed by their governments. But she knows that she will find peace only when Marko will have a grave next to his son's.

## ZA OLGU JE RAT POČEO KASNIJE

Olga je odrastala sanjajući da postane muzičarka. Seća se dobrih vremena kada je zajedno sa suprugom Markom radila u prosveti, zajedno sa Albancima, sa kojima su delili sreću i žalost, slavili Uskrs i Bajram.

Nikada nije mislila da će doživeti gubitak sina, kada joj je 22-godišonji Srđan, izgubio život igrom slučaja prelazeći šine 1997. Ali, još je manje očekivala da će izgubiti Marka, da će joj biti spaljena kuća u Uroševcu i da će ostati usamljena u Župi u Štrpcu.

Marko je poslednji put viđen u jednoj školi u Uroševcu, 28. septembra 1999. Pod pratnjom poljskog KFOR-a, on je otišao da preuzme dokumentaciju srpskih prosvetnih radnika. Pripadnici KFOR-a su ostavili Marka u školi i otišli da isprate nekog u posetu u blizini. Kada su se vratili nisu našli Marka.

Razočarana, Olga je sama pokušavala da rasvetli Markovu sudbinu. Sve što je dobila od organa KFOR-a je bila "potvrda" na kojoj je pisalo da je Marko brutalno ubijen. Međutim njegovo telo nikada nije pronađeno. Nestao je na drugu godišnjici tragične smrti sina Srđana.

Olga se seća njegovih poslednjih reči pre nego što je krenuo za Uroševac. "Ako mi se nešto desi, molim te čuvaj mi porodicu". Nosio je crnu odeću jer je još bio u crnini zbog majke koja mu je umrla 5 meseci pre toga.

Olga se seća njenog muža, koji je bio častan, skroman, solidaran čovek i veliki radnik. Pomagao je ljudima bez obzira na nacionalnost i ekonomsko stanje. Ona pronalazi snagu da nastavi sa životom, sećajući se ohrabrivanja Marka da nastavi dalje. Takođe, Olga se nada da će Albanci i Srbi jednog dana prevazići prepreke koje su im postavile njihove vlade. Međutim, ona zna da će pronaći mir jedino kada joj Marko bude sahranjen pored njihovog sina.









TË JETOSH ME KUJTIMET
E TË PAGJETURVE

LIVING WITH THE MEMORIES
OF THE MISSING

ŽIVETI UZ SEĆANJE
NA NESTALE











TË JETOSH ME KUJTIMET E TË PAGJETURVE

LIVING WITH MEMORIES OF THE MISSING

ŽIVETI UZ SEĆANJE NA NESTALE

TË JETOSH ME KU
NJE NA NESTALE
WITH MEMORIES OF THE MISSING
ŽIVETI UZ S
JE NA NESTALE
TË JETOSH
OSH ME KUJTIMET E TË PAGJETURVE
THE MISSING
ŽIVETI UZ S
ETURVE
TË JETOSH
OSH ME KUJTIMET E TË PAGJETURVE
H MEMORIES OF THE MISSING



# ATË DITË KA QENË I LUMTUR SHUMË

# HE WAS VERY HAPPY THAT DAY

# TOG DANA JE BIO VEOMA SREĆAN

Fatime Qerkini



## ATË DITË KA QENË I LUMTUR SHUMË

Fatime dhe Bajram Qerkinit, lufta e fundit, ua humbi edhe fotografitë nga fëmijëria e Reshatit, djalit të tyre të zhdukur. Banesa e tyre në Mitrovicën veriore, ku ajo e kishte përshëndetur të birin për herë të fundit, ishte tërësisht e shkatërruar kur Fatimja u kthye pas luftës.

Me shpresën që do ta takonte të birin, ajo u kthye aty menjëherë përkundër rrezikut të madh nga forcat dhe paramilitarët serbë.

Fatimja kujton se si për Reshatin ishte bërë i padurueshëm represioni masiv që regjimi i Milloshevigit po ushtronte mbi shqiptarët në Kosovë. "Do të shkoj atje ku po shkojnë të gjithë të rinjtë, edhe nëse duhet të vdes, siç po vdesin të tjerët" – i thoshte ai nënës së tij gjatë kohës që po planifikonte largimin nga shtëpia.

"Unë do ta ndjek rrugën e Babës Sadik", u kishte lënë porosinë e shkruar prindërve para se të largohej për herë të fundit, duke iu referuar kështu gjyshit të tij i cili kishte qenë i përfshirë në luftën e 1945-ës ku ishte zhdukur për të mos u gjetur më.

"Sikur ta dija që ai nuk do të kthehet më, do ta kisha përcjell bile deri në fund të shkallëve"

Ajo ende e dëgjon zërin e tij tek e thërret "Nimee" – ashtu siç ishte mësuar ai ta thërriste nënën.

Nuk ka minutë që nuk kujtohet për djalin e saj, ndarjen nga i cili e përjeton si t'i jetë ndarë një copë nga trupi. "Reshati ka qenë ka qenë njeri i ndjeshëm për vuajtjet e të tjerëve"

"Kam qef me dal dikun n'mal. Vet, vet, veq vet edhe me thirr "Reshat!" Sa t'muj."

# HE WAS VERY HAPPY THAT DAY

Fatime and Bajram Qerkini, during the last war have lost even the childhood photos of Reshat, their missing son. Their apartment in northern Mitrovica, where Fatime had greeted her son for the last time, was completely ruined when she returned there after the war.

In the hope that she would meet her son, she returned there immediately, despite the great danger from Serbian forces and paramilitaries.

Fatime recalls how Reshat had become impatient with the mass repression that Milosevic's regime was exerting on Albanians in Kosova. "I will go where all the young men are going, even if I have to die, as others are dying," he would tell her mother while planning to leave home.

"I will follow the path of Father Sadik" he had left a written message to his parents before leaving for the last time, referring to his grandfather, who had been involved in the 1945 war when he had disappeared and never found again.

"If I knew he would not return, I would have seen him off to the end of the stairs."

She still hears his voice calling "Nime", as he was used to refer to his mother.

There is no minute she does not think of her son, the separation from whom she experiences as if having lost a piece of her own body. "Reshat was a man sensitive to the sufferings of others"

"I'd like to go somewhere in the mountain. Alone, all by myself, and cry out loud 'Reshat!' as much as I can."

## TOG DANA JE BIO VEOMA SREĆAN

Fatimi i Bajramu Qerkini je poslednji rat izbrisao čak i fotografije iz detinjstva Reshata, njihovog nestalog sina. Njihov stan u severnom delu Mitrovice, gde je ona pozdravila sina poslednji put, je bio u potpunosti uništen kada se je Fatima vratila posle rata.

S nadom da će se sresti sa sinom, ona se je odmah vratila uprkos velikoj opasnosti od srpskih snaga i paravojnih formacija.

Fatima se seća kako je za Reshata bila neizdrživa masivna represija koju je Miloševićev režim sprovodio nad kosovskim Albancima.

"Otići ću tamo gde ide sva omladina, čak iako poginem, kao što ginu i drugi" – govorio je on njegovoj majci dok je planirao da napusti dom.

"Ja ću da pođem putem bâbe Sadika", ostavio je napisanu poruku njegovim roditeljima pre nego što je otišao po poslednji put, a pozivajući se ovim na njegovog dedu koji je bio uključen u ratu 1945, kada je nestao i nije nikada pronađen

"Da sam znala da se više neće vratiti, ispratila bih ga makar do kraja stepeništa".

Ona i dalje čuje njegov glas kako je zove "Nimee" – kako se je bio naučio da zove majku.

Ne prođe ni minut a da se ona ne seti njenog sina, čije odvajanje doživljava kao da joj je odvojen deo tela. "Reshat je bio čovek saosećajan na patnje drugih".

"Želeo bih da izađem negde u šumu. Sâm, sâm i samo sâm i da uzvikujem Reshate! Na sav glas".







ARTEFAKTET
RESHAT(BAJRAM) QERKINAJ
I LINDUR MË 26.09.1970 NË MITROVICË. ËSHTË RRËMBYER NGA FORCAT SERBE MË 04.06.1998 MITROVICË.NUK DIHET ASGJË PER FATIN E TIJ.










СУПЕРМАРКЕТ






Reshat Qerkini

Katalogimi në botim – **(CIP)**
Biblioteka Kombëtare  e Kosovës "Pjetër Bogdani"

94(496.51)(092)(084.12)

Koliqi, Kushtrim
Të jetosh me kujtimt e të pagjeturve / Kushtrim Koliqi ;
përktheu Gazmend Bërlajolli, Bruno Neziraj ;
fotografitë Atdhe Mulla. –
Prishtinë : Integra, 2019. – 68 f. : ilustr. ; 21 cm.

Titulli dhe teksti paralel në gjuhën shqipe, angleze dhe serbe.

1.Bërlajolli, Gazmend   2. Neziraj, Bruno   3. Mulla, Atdhe

**ISBN 978-9951-8941-4-2**

inTegra

forumZFD

Missing Persons Resource Center

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova – Republic of Kosovo
*Kuvendi – Skupština – Assembly*

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

**Swiss Agency for Development and Cooperation SDC**

Rockefeller Brothers Fund
Philanthropy for an Interdependent World

BMZ
Federal Ministry for Economic Cooperation and Development

ISBN 978-9951-8941-4-2
9 789951 894142

